



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOLEGJI ZGJEDHOR PRANE GJYKATES SE APELIT
TIRANE

Nr. 43 i Rregj. Themeltar

Nr. 49 i Vendimit

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë i përbërë nga :

KRYESUES : TOM NDRECA
ANETAR : ENTELA PRIFTI
ANETAR : ASTRIT KALAJA
ANETAR : SASHENKA JONUZAJ
ANETAR : PETRAQ DHIMITRI

Asistuar prej sekretarës *Yllka Cika* mori në shqyrtim, sot me *datë 03.06.2011*, ne seance gjyqësore publike çështjen nr. 43 Akti që i perket:

PADITES : **Partia Socialiste e Shqipërise**, *perfaqësuar nga avokatet Eno Bushi, Arjan Salati dhe Damian Gjikhuri.*

I PADITUR : **Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve**. *perfaqësuar nga Deshira Pasko.*



PALE E INTERESUAR : Partia Demokratike e Shqipërise,
perfaqësuar nga Ivi Kaso dhe Oerd Bylykbashi.

OBJEKTI I PADISE : Konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të Vendimit të KQZ nr. 709, date 23.05.2011 “ Per vleresimin e fleteve të votimit të pavleresuara dhe të panumeruara për Kryetarin, Këshillin e Bashkise Tirane, kryetarin e njesise bashkiake dhe keshillin e njësise bashkiake, të cilat aksidentalisht nuk jane hedhur ne kutite respektive të votimit të se njejtës qender votimi ne zgjedhjet e Bashkise Tirane te dates 8 maj 2011“ të vendimit të KQZ te dates 18.05.2011 (të miratuar ne parim), si dhe anulimin e të gjitha vendimeve dhe veprimeve administrative të kryera nga KQZ-ja per rivleresimin, rinumerimin dhe ndryshimin e tabelave e tabelave të rezultateve, sipas anekseve nr.1-8 bashkengjitur vendimit.

BAZA LIGJORE : *Nenet 21, 23, 24, 116, 117, 118, 119, 120, 122, 123, 144, 145, 152, 153, 155, 156 158 te Kodit Zgjedhor, nenet 2, 106, 115, 116 e vijues te Kodit te Procedurave Administrative, nenet 324, 331 e vijues te Kodit te Procedures Civile.*

KOLEGJI ZGJEDHOR I GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Pasi dëgjoji perfaqësuesit e paditësit Partia Socialiste e Shqipërise, avokatët Eno Bushi dhe Arjan Salati, të cilët kërkuan pranimin e padise sipas objektit, degjoji perfaqësuesen e të paditurit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Deshira Pasko, e cila kerkoi rrëzimin e padisë të paditësit Partia Socialiste e Shqipërise, dëgjoji perfaqësuesit e palës se interesuar



Partia Demokratike e Shqipërise, Ivi Kaso dhe Oerd Bylykbashi, të cilët kerkuan rrëzimin e padisë të paditësit Partia Socialiste e Shqipërise, administroj provat dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Se padia e paraqitur prej paditësit Partia Socialiste e Shqipërise duhet të rrëzohet përse i përket pretendimit lidhur me konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të Vendimit të KQZ nr. 709, date 23.05.2011 “Për vlerësimin e fletëve të votimit të pavlerësuarra dhe të panumëruara për Kryetarin, Keshillin e Bashkisë Tirane, kryetarin e njësisë bashkiake dhe keshillin e njësisë bashkiake, të cilat aksidentalisht nuk janë hedhur në kutitë respektive të votimit të së njëjtës qëndër votimi në zgjedhjet e Bashkisë Tiranë të datës 8 maj 2011”. Për pjesën tjetër të pretendimeve, duhet të pushohet gjykimi (*Neni 158/2, 3 i Kodit Zgjedhor dhe neni 126 i Kodit të Procedurës Civile*).

Rrethanat e faktit :

Nëpërmjet Vendimit nr.709, date 23.05.2011 të te paditurit Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (*në vijim KQZ*) është vendosur që tabela e rezultatit të GN-ve për Qëndrat e Votimit dhe Tabela Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për KZAZ-në respektive, të ndryshojë me vendim në varësi të konkluzioneve nga keqyrja dhe vlerësimi i këtyre fletëve votimi të panumëruara dhe të pavlerësuarra. Rezultatet i bashkëlidhen këtij vendimi si anekse të tij. Anekset janë pjesë e pandarë e këtij vendimi (*pika 1*). Gjithashtu është vendosur që

ndryshimet sipas pikes 1 të këtij vendimi të pasqyrohen dhe të llogariten në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për kryetar të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë (*pika 2*).

Nga procesverbali i mbledhjes së KQZ-së, i administruar si provë në gjykim, rezulton se në datën 18.05.2011 pala e paditur KQZ ka nisur një procedurë për vlerësimin e fletëve të votimit për Kryetarin dhe Këshillin e Bashkisë Tiranë, të cilat gjëndeshin në kutitë e gabuara. Nuk rezulton që për këtë aspekt të procedimit administrativ të ekzistojë një akt



vendimmarrjeje me tërësinë e elementëve formalë të nevojshëm për identifikimin dhe referencën e tij.

Nëpërmjet kërkesë padisë së paraqitur për shqyrtim në datën 27.05.2011 paditësi Partia Socialiste e Shqipërisë (*ne vijim, PSSH*) pretendon konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të Vendimit të KQZ nr. 709, datë 23.05.2011 “Për vlerësimin e fletëve të votimit të pavlerësuarra dhe të panumëruara për Kryetarin, Keshillin e Bashkisë Tiranë, kryetarin e njësisë bashkiake dhe këshillin e njësisë bashkiake, të cilat aksidentalisht nuk janë hedhur në kutitë respektive të votimit të së njëjtës qëndër votimi në zgjedhjet e Bashkisë Tiranë të datës 8 maj 2011 “, të vendimit të KQZ të datës 18.05.2011 (te miratuar në parim), si dhe anulimin e të gjitha vendimeve dhe veprimeve administrative të kryera nga KQZ-ja për rivlerësimin, rinumërimin dhe ndryshimin e tabelave të rezultateve, sipas anekseve nr.1-8 bashkëngjitur vendimit. Padia bazohet në nenet 21, 23, 24, 116, 117, 118, 119, 120, 122, 123, 144, 145, 152, 153, 155, 156 158 të Kodit Zgjedhor.

Pretendimet e palës paditese :

Referuar përmbajtjes së objektit të padisë, bazës juridike të saj dhe argumentimit të palës paditëse në kërkesë padi, rezulton se pretendimet kryesore të saj renditen si më poshtë :

a) vendimi i KQZ-së nr. 709, datë 23.05.2011 është një akt normativ dhe, si i tillë, kërkon respektimin e *cuourumit* të votave të anetareve të KQZ-së për t’u konsideruar i vlefshëm, sipas përcaktimeve të nenit 24 të Kodit Zgjedhor. Duke qënë se nuk është miratuar me të paktën pesë vota të këtyre anëtarëve, atëhere ky vendim është një akt absolutisht i pavlefshëm, për arsye të shkeljes së rëndë të procedurës së miratimit të tij. Sipas paditësit, ky akt është miratuar sipas procedurës së miratimit të akteve normative (*neni 23/3 i Kodit Zgjedhor*) dhe gëzon të gjitha cilësitë e aktit normativ sic janë : përcakton rregullime me fuqi juridike të përgjithshme, parashikon hipoteza abstrakte, të cilat nuk dihet me siguri nëse do të mund të zbatohen në të ardhmen si dhe nuk shteron me një akt të vetëm zbatimi.




b) vendimi i KQZ-së nr.709, datë 23.05.2011 është i paligjshëm edhe në lidhje me përmbajtjen e tij, pasi ka vendosur rregulla të reja sjelljeje në një fazë që konsiderohet tashmë e kapërcyer. Sipas paditësit, nuk përlligjet vendimmarrja e KQZ-së për ndryshimin arbitrar të rregullave të lojës në mes apo në fund të procesit zgjedhor. KQZ ka kryer një procedurë rivlerësimi të fletëve të votimit të numëruara, të vlerësuara e të përfshira në rezultatet e QV-ve e të tabelave përmbledhëse të KZAZ-ve. Kjo procedurë e ndjekur nga KQZ vjen në kundërshtim me nenet 116, 117, 118, 119, 122 dhe 123 të Kodit Zgjedhor. Pra, KQZ, duke u shndërruar në rastin e Bashkisë së Tiranës në një KZAZ që në këtë fazë të procesit, e ka shndërruar veten në një organ inkompetent.

c) nga ana e KQZ-së, në marrjen e vendimit nr.709, datë 23.05.2011 është ndjekur një procedurë ekstraligjore, në kundërshtim me nenin 123 të Kodit Zgjedhor. Sipas kësaj dispozite, KQZ bën vetem mbledhjen matematikore të të dhënave që pasqyrohen në tabelat e rezultateve të KZAZ-ve, ose, sipas rastit, të tabelave të rezultateve për çdo QV. Nuk mund të ndryshohen tabelat e të dhënave, përveç rastit kur ka një gabim material ose në alternativën kur KQZ është në fazën e shqyrtimit të një kërkesë ankimore ndaj vendimeve të KZAZ-së apo vendimit të saj.

d) të gjitha vendimet e ndërmjetme, të cilat kanë ndryshuar tabelat e rezultateve të hartuara nga GNV-të e të miratuara nga KZAZ-të përkatëse i bëjnë vendimet e datës 18.05.2011, vendimin nr.709, datë 23.05.2011, vendimet e ndërmjetme si dhe veprimet administrative të palës së paditur KQZ si në kundërshtim flagrant me ligjin dhe një cënim të hapur të parimeve të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Prapsimet e palës së paditur :

a) vendimi nr.709, datë 23.05.2011 i KQZ-së nuk është akt normativ, por një akt me karakter individual. Ky vendim nuk vendos rregulla sjelljeje me karakter të përhershëm, por shqyrton kërkesat individuale të disa KZAZ-ve, të cilat administrojnë procesin zgjedhor për




njësive zgjedhore Bashkia Tiranë si dhe kërkesën e një subjekti zgjedhor, për fenomene konkrete të ndodhura gjatë procesit të numërimit të votave në VNV-të e këtyre njësive zgjedhore. Me anë të këtij vendimi KQZ bëri vlerësimin e votës vetëm për QV-të e nëntë ZAZ-ve. Karakterin normativ të aktit nuk e përcakton menyra e votimit të tij.

b) KQZ ka konstatuar në tërësi mungesën e një qëndrimi uniform lidhur me një kategori votash të caktuara të hedhura në kutinë e gabuar të votimit nga ana e KZAZ-ve. Këto fletë votimi të hedhura aksidentalisht në një kuti tjetër të së njëjtës qëndër votimi nuk janë numëruar dhe vlerësuar në përputhje me kriteret e neneve 116, 117 dhe 118 të Kodit Zgjedhor. Anëtarët e GN-ve dhe të KZAZ-ve janë vënë në pamundësi ligjore për të përcaktuar nëse këto vota ishin të vlefshme apo të pavlefshme. Në kushtet e mbajtjes së qëndrimeve alternative nga ana e KZAZ-ve për këtë aspekt, KQZ konstatoi se këto fletë votimi janë konsideruar herë si të kontestuara dhe herë si të pavlefshme, pavarësisht se pranohej se nuk përmbusheshin kriteret e nenit 117 të Kodit Zgjedhor për t'u konsideruar si vota të pavlefshme.

c) administrata zgjedhore është e organizuar në mënyrë hierarkike dhe KQZ është organi më i lartë shtetëror epror i kësaj administrate. KQZ drejton, organizon, menaxhon, mbikëqyr dhe kontrollon strukturat administrative të varesise, dhe, sipas rastit, ushtron të gjitha kompetencat e organeve të varesise kur ato nuk i ushtrojnë ose kanë pamundësi për t'i ushtruar ato. Ky rol i KQZ-së përcaktohet në nenet 2/7, 21/1,2,3,11, 28, 29, 35/5 dhe 42/5 të Kodit Zgjedhor.

d) referuar traditës së KQZ në ushtrimin e funksioneve të saj konstatohet se edhe në zgjedhjet e mëparshme për Kuvëndin e Shqipërisë dhe zgjedhjet për njësitet e organet e qeverisjes vendore është ushtruar ky rol prej KQZ-së dhe nuk ka patur asnjëherë kontestime prej palëve të interesuara në proces. Këtu është fjala për vendime të KQZ-së në zgjedhjet e viteve 2001, 2003, 2007, 2009, në të cilat, edhe me miratimin e anëtarëve të palës paditëse, është vepruar për numërimin e votave në shumë qëndra votimi.



e) referuar Rekomandimit nr.27 të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e 28 qershorit 2009, KQZ ka detyrimin t'i kushtojë vëmendje faktit të zhvillimit të hetimeve të veta administrative në lidhje me votimin dhe numerimin e votave, bazuar ne konstatimet e KQV-ve, KZAZ-ve dhe të grupeve të numerimit. Duhet të mbahen parasysh përcaktimet e Kodit të Praktikës së Mire në Çështjet Zgjedhore, pika 49, lidhur me vlefshmërinë dhe pavlefshmërinë e fletëve të votimit, duke u nisur nga kriteri i *qëllimit të votuesit*. Fletët e votimit të hedhura aksidentalisht në kutine e gabuar brenda të njëjtes qënder votimi janë të vlefshme, pasi nuk plotësojnë asnjë kusht pavlefshmërie, sipas nenit 117 të Kodit Zgjedhor.

Prapsimet e pales se interesuar :

a) vendimi i KQZ-së nr.709, datë 23.05.2011 nuk është akt normativ, por një akt me karakter individual, nuk vendos rregulla të pergjithshme sjelljeje, nuk ka karakter të perhershëm dhe ka karakter shterues. Gjithashtu, pala e interesuar prapson se të ndryshosh rregullat e lojës do të thotë të ndryshosh substancën e ligjit dhe jo procedurën e tij. Nuk ka një KZAZ të madhe për Tiranën sikundër për rrethet, por ky rol i përket KQZ-së, ç'ka eshte pranuar edhe nga ana e anëtareve të palës paditëse në KQZ referuar vendimeve të mëparshme të këtij organi.

b) votat e hedhura aksidentalisht nga votuesit ne kutine e gabuar brenda te njejtes qender votimi nuk jane te pavlefshme, bazuar ne nenin 117 te Kodit Zgjedhor, pasi nuk ndodhemi perpara asnje prej rasteve te pavlefshmerise se votes, te parashikuar shprehimisht ne dispozite.

c) referenca duhet te behet edhe ne rastet e meparshme te jurisprudences se gjykatave te vendeve demokratike lidhur me te drejten e votes si te barabarte, te fshehte, te lire, te pacenueshme dhe te patjetersueshme. Perfaqesuesi i pales se interesuar iu referua qendrimit te gjyqtarit te ceshtjes ne rastin e zgjedhjeve te Kontese Riverside, USA dhe qendrimave te Gjykates se Strasburgut ne ceshtjet " *Kerimova v Azerbajxhan* " date 30.09.2010, " *Petkov and others v Bullgaria* " date 11.06.2009 dhe " *Namat Aliyev v Azerbajxhan* " date 08.04.2010, Kodit te Praktikës se Mire ne Ceshtjet Zgjedhore (*pika 49*) dhe Raporti Final i OSBE/ODIHR 2009.



Ligji i zbatueshem.

Ne nenin 6 te Kodit te Procedures Civile parashikohet se : “ Gjykata qe gjykon mosmarreveshjen duhet te shprehet mbi gjithcka qe kerkohet dhe vetem per ate qe kerkohet “.

Ne nenin 28/1 te Kodit te Procedures Civile parashikohet se : “ Gjykata duhet te shprehet per te gjitha kerkesat qe parashtrohen ne padi, pa i kaluar kufijte e saj, duke realizuar nje gjykim te drejte, te pavarur dhe te paanshem brenda nje afati te arsyeshem “.


Ne nenin 115 te Kodit te Procedurave Administrative parashikohet se : “ Pavlefshmeria e akteve administrative, ne kuptimin e ketij Kodi, paraqitet ne format e meposhtme : a) akte administrative absolutisht te pavlefshme (akte te nxjerra ne kundersizim flagrant me ligjin); b) akte administrative relativisht te pavlefshme (akte te nxjerra ne kundersizim me ligjin) “.

Ne nenin 116 te Kodit te Procedurave Administrative parashikohet se : “ Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, ne rastet e meposhtme : a) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ i paidentifikuar; b) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore; c) kur akti eshte nxjerre ne kundersizim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji ”.

Ne nenin 23/2 te Kodit Zgjedhor parashikohet se : “ Aktet me karakter normativ te KQZ-se kane fuqi mbi te gjitha territorin e vendit dhe jane te detyrueshme per te gjitha “.

Ne nenin 23/4 te Kodit Zgjedhor parashikohet se : “ Aktet normative te KQZ-se kane karakter te perhershem dhe zbatohen si rregull per te gjitha zgjedhjet “.

Ne nenin 24/1, germa “ d “ te Kodit Zgjedhor parashikohet se : “ Konsiderohen te miratuara, kur votojne “ pro “ jo me pak se 5 anetare te KQZ-se, vendimet lidhur me aktet me karakter normativ dhe qe kane per qellim rregullimin e ceshtjeve qe lidhen me zgjedhjet “.



Ne nenin 145/1 te Kodit Zgjedhor parashikohet se : “ Subjektet zgjedhore kane te drejte te bejne ankim ne Kolegjin Zgjedhor te Gjykatës së Apelit, Tirane kunder vendimeve te KQZ-se, kur ato cenojne interesat e tyre te ligjshem brenda afatit te percaktuar ne nenin 152 te ketij Kodi “.


Arsyetimi ligjor.

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tirane cmon te pabazuara pretendimet e pales paditese PSSH-se. Keshtu, gjykates i eshte paraqitur per shqyrtim nje padi e natyres administrative, per shqyrtimin e se ciles vlejne rregullat e gjykimit *sui generis*, te parashikuara ne Kodin e Procedures Civile (*nenet 324 – 333*), Kodin e Procedurave Administrative dhe ne Kodin Zgjedhor te miratuar me ligjin nr.10019/2008. Ne kuptim te dispozitave ligjore te mesiperme, objekt i kontrollit gjyqesor *ex post* perceptohet ligjshmeria e aktit administrativ te kundershuar. Kjo nenkupton verifikimin e faktit te respektimit te kriterëve ligjore lidhur me formalitetin e aktit, ashtu sikurse edhe te disponimit themelor permes vendimmarrjes. Eshte e qarte se vlefshmeria e aktit administrativ kushtezohet me ligjshmerine e tij. Koncepti dhe rastet e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ parashikohen ne nenet 115/a dhe 116 te Kodit te Procedurave Administrative, te cilat jane pjese e bazes juridike te padise se paditesit PSSH.

Kolegji Zgjedhor vlereson se paditesi PSSH legjitimohet *ratione personae* ne padine ngritur. Paditesi eshte person juridik i rregjistruar si parti politike ne baze te ligjit nr.8580/2000 “ Per partite politike “. Ne zgjedhjet per njesite e qeverisjes vendore te dates 8 maj 2011 paditesi eshte rregjistruar ne perputhje me Kodin Zgjedhor duke u konsideruar tashme si *subjekt zgjedhor*, ne kuptim te neneve 2/20, 64 dhe 65 te Kodit Zgjedhor.

Paditesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi kerkesë padia e tij per konstatimin e pavlefshmerise absolute te Vendimit te KQZ-se nr.709, date 23.05.2011 eshte paraqitur ne gjykate brenda afatit te parashikuar ne nenin 152/2 te Kodit Zgjedhor.


Paditesi legjitimohet *ratione materiae* ne padine e ngritur, per shkak



te relacionit te qarte midis funksionit e veprimtarise ligjore te ketij subjekti zgjedhor dhe ceshtjes se paraqitur per shqyrtim perpara Kolegjit Zgjedhor. Referuar kuptimit kushtetues dhe ligjor, partite politike paraqiten si bashkime vullnetare te shtetasve mbi bazen e ideve, te bindjeve e te pikepamjeve politike te perbashketa, qe synojne te ndikojne ne jeten e vendit nepermjet pjesemarrjes ne zgjedhje dhe perfaqesimit te popullit ne organet e zgjedhura te pushtetit. Partite politike ne sistemin e zgjedhjeve e vecanerisht ne procesin zgjedhor, qe nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidateve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri tek ndarja e mandateve, paraqiten si nje faktor percaktues shume i rendesishem. Prandaj, demokracia perfaqesuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund te paramendohen pa ekzistencen dhe funksionimin e partive politike. Mbi bazen e ketij arsyetimi, Kolegji Zgjedhor vlereson legjitimitimin e paditesit ne rastin ne shqyrtim (*Shih Vendimin e Gjykates Kushteuese nr. 32, date 21.06.2010*).

Nga nje veshtrim formalist i aktit administrativ te kontestuar nga paditesi PSSH rezulton qe titulli i tij eshte formuluar si “*Per vleresimin e fleteve te votimit te pavleresuara dhe te panumeruara per Kryetarin, Keshillin e Bashkise Tirane, kryetarin e njesise bashkiake dhe keshillin e njesise bashkiake, te cilat aksidentalisht nuk jane hedhur ne kutite respektive te votimit te se njejtes qender votimi ne zgjedhjet e Bashkise Tirane te dates 8 maj 2011* “, nderkohe qe ne pjesen e dispozitivit te tij, ky vendim percakton se tabela e rezultatit te GN-ve per Qendrat e Votimit dhe Tabela Permbledhese te Rezultatit per zgjedhjet per KZAZ-ne respektive, te ndryshoje me vendim ne varesi te konkluzioneve nga keqyrja dhe vleresimi i ketyre flete votimi te panumeruara dhe te pavleresuara. Rezultatet i bashkelidhen ketij vendimi si anekse te tij. Anekset jane pjese e pandare e ketij vendimi (*pika 1*). Gjithashtu eshte vendosur qe ndryshimet sipas pikes 1 te ketij vendimi te pasqyrohen dhe te llogariten ne Tabelen Permbledhese te Rezultatit per zgjedhjet per kryetar te zones zgjedhore Bashkia Tirane (*pika 2*).

Titulli i ketij vendimi lidhet ne menyre uniforme me problematiken e shqyrtuar prej te paditurit KQZ per rastet e hedhjes aksidentalisht ne



kutine e gabuar te fleteve te votimit per kryetarin, keshillin e bashkise Tirane, kryetarin e njesise bashkiake dhe keshillin e njesise bashkiake te se njejtës qender votimi. Sipas KQZ-se, keto flete votimi nuk jane perfshire ne rezultat, pavaresisht vullnetit te qarte te shprehur nga zgjedhesit. Per shkak te praktikave te ndryshme te ndjekura na ana e KZAZ-ve dhe mungeses se udhezimeve apo rregullave te posacme ne manualet e punes se GNV-ve dhe KZAZ-ve, KQZ ka vendosur te keqyre te gjitha kutite e votimit dhe te vleresoje fletet e votimit te hedhura aksidentalisht duke i perfshire ne rezultat.

Pavaresisht *nomen juris*, Vendimi nr.709, date 23.05.2011 i KQZ-se eshte vendim per ndryshimin e rezultatit te GN-ve per qendrat e votimit dhe te Tabeles Permbledhese te Rezultatit te KZAZ-ve respektive ne varesi te konkluzionit te keqyrjes dhe vleresimit te votave te hedhura aksidentalisht e kutine e gabuar, te panumeruara dhe te pavleresuara. Pra, nepermjet ketij vendimi eshte rregulluar nje mosmarreveshje e lindur ne fazen e numerimit dhe te vleresimit te votave ne fazen e procesit zgjedhor te ushtrimit te funksioneve prej GNV-ve dhe KZAZ-ve lidhur me nje kategori votash te hedhura aksidentalisht ne kutine e gabuar brenda te njejtës qender votimi. Sic verehet, percaktimi i gjendur ne titullin e ketij vendimi te KQZ-se mund te kuptohet si argument i perdorur nga ana e ketij autoriteti per arritjen e rezultatit te vendimmarrjes, te specifikuar ne dispozitivin e vendimit. Ne nje kendveshtrim proporcional te analizes se elementeve te vendimit te KQZ-se, peshen kryesore e mban dispozitivi, ose pjesa urdheruese e tij, sic formulohet nga neni 144/2, germa “ dh “ i Kodit Zgjedhor, pasi lidhet drejtperdrejt me shprehjen e vullnetit te autoritetit administrativ dhe nevojten per garancine e arritjes se efektit ekzekutiv te vendimit.

Nese i referohemi pretendimeve te pales paditese PSSH, arrihet ne konkluzionin se kerkimi per pavlefshmeri absolute te Vendimit nr.709, date 23.05.2011 te KQZ-se ngrihet per veprimtari te KQZ-se tej kompetencave ligjore te parashikuara ne Kodin Zgjedhor. Konkretisht, paditesi pretendon se, pavaresisht cilesise si *akt normativ*, Vendimi nr.709, date 23.05.2011 eshte miratuar me kater vota *pro* te anetareve te



KQZ-se. Inkompetenca e KQZ-se pretendohet edhe ne rastin e rolit aktiv te KQZ-se per te numeruar dhe vleresuar votat e hedhura aksidentalisht ne kutine e gabuar brenda te njejtës qender votimi.

Kolegji Zgjedhor vlereson se, per t'i dhene pergjigje pretendimit te pales paditese PSSH lidhur me cilesine e Vendimit te KQZ-se nr.709, date 23.05.2011 si *akt normativ* apo *akt individual* duhet te referoje tek dispozitat e Kodit te Procedurave Administrative dhe ne doktrinen e se drejtes administrative. Kodi i Procedurave Administrative nepermjet nenit 105 ka sanksionuar se akte administrative, ne kuptim te ketij ligji jane vetem aktet, te cilat krijojne pasoja juridike ne raste individuale. Ndarja qe teoria e se drejtes administrative i ben akteve te nxjerra nga organet e administrates publike ne *akte individuale* dhe *akte normative* paraqitet si i rendesishem, pasi nga kuptimi i drejte dhe i qarte i secilit akt varen hyrja e tyre ne fuqi si dhe organi perkates gjyqesor qe do t'i shqyrtoje per efekt te vlefshmerise se tyre.

Akti administrativ individual rregullon ne vecanti marredhenie konkrete, te posaçme, per nje çeshtje specifike dhe ndaj nje subjekti apo grupi subjektsh te percaktueshem. Nepermjet *aktit individual* nuk vendosen norma te pergjithshme abstrakte. Karakteri individual i aktit dallohet nga specifika e problemit konkret qe ai rregullon.

Akti normativ ne dallim nga akti individual vendos rregulla te detyrueshme sjelljeje, ne pergjithesi dhe per nje kompleks marredheniesh juridike, Pra, ky akt juridik vendos norma te reja sjelljeje, te cilat marrin karakterin e rregullave te detyrueshme, moszbatimi i te cilave perben paligjshmeri.

Ne te dyja rastet e akteve, qofte individuale apo edhe normative, dallimi ndermjet tyre behet ne baze te personave qe ju drejtohet, apo fakteve e marredhenieve juridike qe merr parasysh veprimin administrativ. Nese nje akt apo veprim administrativ synon nje numer te caktuar njerezish, ose lidhet me fakte te caktuara, ai eshte konkret dhe i specifikuar. Por nese akti ka te beje me nje numer te pacaktuar njerezish e faktesh, ai eshte abstrakt dhe i pergjithshem.




Duke iu kthyer rastit të paraqitur për shqyrtim, Gjykata e Apelit vlerëson se Vendimi i KQZ-se nr.709, datë 23.05.2011 nuk gëzon cilësi të një akti normativ, në kuptim të nenit 23/2 të Kodit Zgjedhor, por përben një akt individual, i cili, në kuptim të nenit 24/1, paragrafi i fundit të Kodit Zgjedhor, miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ-se.

Konkretisht, nëpërmjet këtij vendimi është rregulluar një marrëdhënie juridike specifike, e cila ka lindur pas kërkesës së disa KZAZ-ve të njësive zgjedhore Bashkia Tirane lidhur me fatin e një kategorie votash të hedhura aksidentalisht në kutinë e gabuar brenda të njëjtes qender votimi. Statusi juridik i kësaj marrëdhënieje nuk shtrihet në të gjitha KZAZ-te të njësive zgjedhore Bashkia Tirane dhe aq më pak në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi aktivizimi i KQZ-se rezultoi vetëm për nente ZAZ të kësaj njësie zgjedhore.

Gjithashtu, disponimi i KQZ-se nëpërmjet këtij vendimi është konkret, pra, nuk ka natyrë abstrakte. KQZ ka vendosur që të përfshijë në tabelat e rezultateve të disa QV-ve dhe Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet në KZAZ-te respektive fletet e votimit të panumeruara dhe të pavlerësuar, ndryshime të cilat do të pasqyrohen edhe në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për kryetar të zonës zgjedhore Bashkia Tirane. Është e kuptueshme nga natyra e problematikes së marrë në shqyrtim dhe të ezauruar nëpërmjet procesit vendimarrës prej KQZ-se se nuk ndodhemi për një akt me natyrë jo shtruese. Përkundrazi, pala e paditur KQZ i ka dhënë përgjigje përfundimtare ceshtjes së ngritur përpara saj nga ana e disa KZAZ-ve duke përcaktuar po në mënyrë përfundimtare edhe statusin ligjor të fleteve të votimit të panumeruara e të pavlerësuar të hedhura aksidentalisht në kutinë e gabuar brenda të njëjtes qender votimi, duke i përfshirë votat e vlefshme në rezultat.

Kolegji Zgjedhor vlerëson se, në kundërshtim me sa pretendohet nga paditesi PSSH, KQZ nuk ka vepruar në kapërcim të kompetencave të saj në marrjen e Vendimit nr.709, datë 23.05.2011 (*neni 116/b i Kodit të Procedurave Administrative*) kur e ka miratuar këtë vendim me kater vota *pro*, pasi nuk behet fjale për akt normativ, por për akt me karakter



individual. Nisur nga roli i KQZ si organ me funksione *quasi* gjyqesore ne hierarkine e organeve te administrimit te zgjedhjeve si dhe natyres se ceshtjes se parashtruar per zgjidhje perpara KQZ-se, Kolegji Zgjedhor vlereson se Vendimi i KQZ-se nr.709, date 23.05.2011 ka zgjidhur ne menyre perfundimtare ceshtjen e shtruar per zgjidhje para tij duke urdheruar ndryshimin e tabelave te rezultateve te GN-ve per Qendrat e Votimit dhe Tabelat Permbledhese te Rezultatit per KZAZ-te respektive ne varesi nga konkluzioni i keqyrjes dhe vleresimit te fleteve te votimit te panumeruara dhe te pavleresuara. Keto rezultate i jane bashkelidhur vendimit si anekse te tij dhe keto anekse jane pjese e pandare e ketij vendimi.


Pra, Vendimi nr.709, date 23.05.2011 i KQZ-se konsiderohet si *vendim perfundimtar* lidhur me mosmarreshjen e parashtruar per zgjidhje ketij organi prej KZAZ-ve te njesise zgjedhore Bashkia Tirane, pasi ka zgjidhur ne menyre substanciale problematiken e lindur prej faktit te hedhjes aksidentale te disa fleteve te votimit ne kutite e tjera te se njejtes qender votimi dhe qe nuk jane numeruar e vleresuar nga ana e GNV-ve dhe KZAZ-ve respektive duke i pasqyruar keto vleresime ne tabelat e rezultateve, sic ato paraqiten bashkengjitur vendimit.

Pse akti nuk eshte absolutisht i pavlefshem

Duke iu referuar kerkimit te pales paditese dhe bazes ligjore te perdorur prej saj ne kerkese padi, konstatohet se ne kerkimin e saj ajo i referohet vendimit nr. 709 dt. 23.05.2011 te KQZ si akt administrativ absolutisht i pavlefshem, bazuar ne nenet 116 e 117 te K.Pr.Administrative.

Ne analize te provave te paraqitura prej paleve ne gjykim dhe te aktit objekt kundershimi nga pala paditese Kolegji Zgjedhor konstaton, se nuk plotesohet asnje prej rasteve te parashikuara nga neni 116 i K.Pr.Administrative per tu konstatuar pavlefshmeria absolute e aktit administrativ, vendimi nr 709 dt. 23.05.2011 i K.Q.Z Tirane.

Akti eshte nxjerre nga nje organ i identifikuar siç eshte K.Q.Z, organ i përcaktuar dhe autorizuar nga ligji qe ne funksion te realizimit te detyrimeve te tij ligjore legjitimohet te shqyrtoje ceshtjet administrative




qe lidhen me procesin zgjedhor ne Republiken e Shqiperise. Akti i nxjerre nga ky organ ka te gjitha ekstremitetet e nje akti te mirefillte administrativ si simboli i organit, data e nxjerrjes, firmat e perfaqesuesve te tij, te dhena keto qe e bejne ate te vlefshem ne kuptim te pikes "a" te nenit 116 te K.Pr.Administrative.

Persa i perket kompetences se pales se paditur K.Q.Z per te nxjerre kete akt sipas pikes "b" te nenit 116 te K.Pr.Administrative, Kolegji çmon se edhe ne kete rast pretendimet e pales paditese jane te pabazuara dhe pala e paditur K.Q.Z ka vepruar brenda kompetencave ligjore te saj. Ne gjykim u provua se pala e paditur K.Q.Z u vu ne levizje per shqyrtimin e kerkesave te ardhura nga KZAZ-te e Bashkise Tirane për problemin e dale gjate numerimit te votave, ne lidhje me votat e hedhura ne kutite e gabuara dhe te pavleresuara. Po ky kerkim i eshte drejtuar asaj edhe nga nje prej subjekteve zgjedhore Partia Demokratike e Shqiperise.

Ndodhur para kesaj situate ishte detyrim ligjor i pales se paditur K.Q.Z i rrjedhur nga neni 21 i K.Zgjedhor, qe te shprehej mbi kete situate zgjedhore te krijuar dhe ti jepte zgjidhje asaj. Ky detyrim i pales se paditur K.Q.Z eshte realizuar nepermjet procedures se ndjekur prej saj per miratimin e vendimit objekt gjykimi. Sipas nenit 1 te K.Zgjedhor percaktohet qellimi dhe objekti i ketij Ligji, si Ligj i vetem qe rregullon procesin zgjedhor ne Republiken e Shqiperise. Sipas ketij neni objekt i tij jane percaktimi i rregullave per pergatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikqyrjen si dhe shpalljen e rezulttatit te zgjedhjeve per ne Kuvendin e Shqiperise, per organet e qeverisjes vendore dhe referendumet. Ne kete Kod jane objekt i rregullimit : *"... e) procedura e votimit dhe shpalljes se rezultateve; ë) shqyrtimi i ankimimeve dhe vendosja e sanksioneve administrative dhe penale; f) rregulla te tjera ne lidhje me zgjedhjet"*.

Duke qene se eshte K.Q.Z organi i vetem i percaktuar ne kete ligj qe eshte ngarkuar per zbatimin e tij dhe zgjidhjen e te gjitha çeshtjeve dhe problemeve qe lidhen me zgjedhjet, eshte ky organ qe legjitimohet te shqyrtoje çdo ankese apo problem juridik qe lidhet me mbarevajtjen e procesit zgjedhor, si para dhe pas zgjedhjeve.



Ne kuader te plotësimit te detyrimeve te tij KQZ nuk ka kompetencat e KAZAZ-se, sipas përcaktimeve te nenit 33 te Zgjedhor. Sipas perkufizimit teorik te kompetences ajo eshte e drejta detyra e organit te administrates publike per te ushtruar veprimtari ne zbatim te Ligjit, veprimtari qe shprehet ne teresine e akteve veprimeve qe organi kryen. Pra, kompetenca e organit mund te shihet drejte dhe detyrim per zbatimin e detyrimeve te ngarkuara me ligj.

Ne pretendimet e saj pala paditese ka pretenduar se pala e paditur Q.Z nuk ka kompetence te shqyrtoje nje suate te tille, pasi ajo eshte detyrim i KZAZ-ve. Nje pretendim i tille konsiderohet i pabazuar nga kjo gjyke dhe ne kundërshtim me ligjin. K.Q.Z si organ qendror i administrates gjedhore dhe si i tille ushtron dhe kompetencat e organeve te varesise, ne kushtet kur ato nuk mund te ushtrojne detyrat e tyre. Mbi baze te kesaj cilesie edhe KZAZ-te i jane drejtuar ketij organi per zgjidhjen e nje suate konkrete te krijuar gjate procesit paszgjedhor, e patrajtuar me pare dhe e parregulluar me akte te meparshme nenligjore nga K.Q.Z. Duke qene se pala e paditur K.Q.Z eshte organi kompetent pergjegjes per administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve lokale ne Republiken e Shqiperise dhe ne njesine qeverisese Bashkia Tirane, ka pasur detyrim ligjor per shqyrtimin e ketij rasti te paraqitur dhe zgjidhjen e tij. Ne kuader te ketij detyrimi eshte kryer edhe hetimi administrativ nga pala e paditur dhe nxjerrja e vendimit nr. 709 dt. 23.05.2011 te saj, si perfundim ligjor i ketij hetimi te zhvilluar.

Akti administrativ i kundërshtuar, vendimi nr. 709 dt. 23.05.2011 nuk mund te konsiderohet se shte nxjerre ne shkelje te formes dhe procedures se kerkuar per nxjerrjen e aktit administrativ sipas pikes "c" te K.Pr.Administrative si pretendohet nga pala paditese, ashtu sikurse edhe vendimi i dt.18.05.2011 (i miratuar ne parim). Megjithese i pretenduar nga kjo pale nuk u provua asnje rrethane e shkeljes se procedurave per marrjen e tij, shkelje e tille e rendesishme qe do te çonte ne pavlefshmerine absolute te aktit. Duke iu referuar materialeve te ndodhura ne dosje si procesverbalet e mbledhjeve te K.Q.Z-se, rezulton se shqyrtim administrativ nga ky organ eshte kryer ne perputhje me kerkesat e Ligjit

konkretisht nenit 22 te K.Zgjedhor. Proçedura e ndjekur nga pala e paditur ka qene ne pëpruthje me rregullat e shqyrtimit administrativ te akteve nga organet kolegjiale, si eshte pala e paditur. Mbledhja e pales se paditur eshte kryer konform kerkesave te kesaj dispozite duke u njoftuar rendi i dites, duke u kryer njoftimet e paleve te interesuara dhe me pjesmarrjen e te pakten 4 anetareve te K.Q.Z-se.

Persa i perket menyres se votimit ashtu si u arsyetua me lart, duke qene se akti objekt gjykimi nuk u konsiderua akt normativ ai eshte i vlefshem me shumice te thjeshte te votave te anetareve te pranishem. Sipas teorise te se drejtes administrative, ne rastet e nxjerrjes se akteve adminsitative nga organe kolegjiale siç eshte edhe pala e paditur K.Q.Z duhet te plotesohen nje sere kerkesash ligjore proçeduriale, si menyra e thirrjes se mbledhjes se organit administrativ, percaktimi i rendit te dites, prezenca e shumices se anetareve te ketij organi, mbajtja e proçesverbalit perkates, parimi i degjimit te paleve dhe parimi i paanesise te organit administrativ. Te gjitha keto parime te se drejtes jane zbatuar ne rastin konkret nga pala e paditur K.Q.Z, ne vendimmarrjen e saj.

Nje tjeter aspekt i vlefshmerise te aktit administrativ vendim nr.709 dt.23.05.2011 te K.Q.Z eshte dhe perputhja e tij me permbajtjen e ligjit. Si akt nenligjor nje akt administrativ duhet te jete ne perputhje me ligjin qe ai i referohet. Sipas teorise te se drejtes nje akt ka mosperputhje me Ligjin kur, 1- parashikon ose urdheron kryerjen e veprimeve te caktuara qe Ligji nuk i lejon ose i ndalon dhe 2- kur ndalon ose refuzon te drejta te percaktuara ne Ligj.

Ne rastin konkret nuk jemi para asnje prej ketyre rasteve qe do te conin ne pavlefshmerine e aktit administrativ. Kodi Zgjedhor ne asnje dispozite te tij nuk parashikon moslejimin apo ndalimin e vleresimit dhe numerimit te nje sasie te caktuara votash, qofshin keto te hedhura ne kutine e gabuar, vota qe shprehin qarte vullnetin e zgjedhesve qe kane votuar dhe po keshtu nuk ndalon te drejten e çdo zgjedhesi qe vota e tij te shqyrtohet dhe te vleresohet nese eshte e vlefshme apo jo. Nje akt i tille vjen ne perputhje edhe me qellimin e vete Ligjit, Kodit Zgjedhor qe eshte administrimi i proçesit zgjedhor dhe shpallja e rezultatit te zgjedhjeve, si qellim final pas gjithë proçedurave adminsitative te ndjekura. Eshte

Kushtetuta e Shqipërisë që në nenin 45 të saj ka dhënë përcaktimin e votes dhe është detyrimi Kushtetues për vlerësimin e votes, që detyron KQZ jo vetëm të numerojë por edhe të vlerësojë votat e zgjedhëse në arritjen e qëllimit final, sigurimin e integritetit të procesit zgjedhor.

Pretendimet e palës paditese në kerkese padine e saj kryesisht i referohen pavlefshmerisë të aktit në kuptimin formal të tij, duke e konsideruar si akt normativ dhe linja e kundërshtimit të aktit e kesaj pale mbështetet vetëm në këto aspekt ligjor, arsytimi i të cilave është pjesë e këtij vendimi.

Në lidhje me pretendimin se KQZ ka ndryshuar rregullat e lojës pas zhvillimit të procesit zgjedhor edhe ky çmohet i pabazuar nga Kolegji, pasi në rastin konkret nuk kemi një situatë të tillë. Me vendimin objekt gjykimi KQZ nuk ka normuar rregulla të reja sjelljeje por ka zgjidhur një situatë të re të patrajtuar me parë, situatë e krijuar në një moment të caktuar pas zgjedhor.

Nga pala paditese në asnjë moment megjithëse u pretendua nuk u paraqit si provë asnjë akt apo udhëzim shkresor i K.Q.Z-se që ka rregulluar me parë një situatë të tillë, që të mund të provohej se u ndryshua me vendimin objekt gjykimi. Referimi i kesaj pale në nenin 123 të K.Zgjedhor është i gabuar, pasi situata juridike nuk është pjesë e vlerësimit sipas kesaj dispozite. KQZ ka ushtruar kompetencat e një organi përmbledhës të të gjitha rezultateve dhe tabelave të paraqitura nga KZAZ-te e Tiranës, e kjo procedurë është kryer para kryerjes së detyrimeve të përcaktuara në nenin 123 të K.Zgjedhor.

Përsa i përket kërimit tjetër të kerkese padise, atij për pavlefshmerinë e veprimeve dhe vendimeve të ndërmjetme të KQZ-se, Kolegji Zgjedhor çmon se duhet vendosur pushimi i gjykimit të çështjes. Konstatohet gjatë gjykimit, se këto vendime janë të papërcaktuara si në objektin e padise dhe nuk u përcaktuan as gjatë gjykimit të çështjes nga pala paditese, duke mbetur në këto mënyre abstrakte të tilla që nuk mund të investojnë Kolegjin në shqyrtimin e tyre. Ndodhur në këto rrethana, çmohet se për këto kërime padia duhet të pushohet.



PER KETO ARSYE:

Kolegji Zgjedhor i Gjykeses se Apelit Tirane, bazuar ne nenin 158, pikat 2 dhe 3 te Kodit Zgjedhor, nenet 126 dhe 127 te Kodit te Procedures Civile,

VENDOSI:

Rrezimin e kerkese padise se pales paditese Partia Socialiste e Shqiperise persa i perket kerkeses per konstatimin si absolutisht te pavlefshem te Vendimit nr.709, date 23.05.2011 te pales se paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Tirane.

Pushimin e gjykimit te ceshtjes lidhur me kerkimin per anullimin e vendimeve te ndermjetme te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, Tirane.

Ky vendim eshte i formes se prere.

U shpall ne Tirane, sot me date 03.06.2011.

A N E T A R

ENTE LA PRIFTI

A N E T A R

ASTRIT KALAJA

K R Y E S U E S

TOM NDRECA

A N E T A R

PETRAQ DHIMITRI

A N E T A R

SASHENKA JONUZAJ

